



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Komisioni Qendror i Zgjedhjeve
Centralna Izborna Komisija
Central Election Commission



PROCESVERBAL NGA MBLEDHJA E KOMISIONIT QENDROR TË ZGJEDHJEVE

Nr. 39

Datë: 18.07. 2024 ora:

Vendi: Selia e KQZ-së/ Prishtinë.

Kreshnik Radoniqi, kryetar i KQZ-së.

Anëtarët e KQZ: Ilir Gashi, Arianit Elshani, Alban Krasniqi, Sami Hamiti, Ibrahim Selmanaj, Gordana Llaban, Fazli Stollaj, Qemal Kurtis, Mufera Shinik.

Burim Ahmetaj, krye shef i SKQZ. Besnik Buzhala, drejtor i ZRCKFSP

Përkthyes: Argjina Misini; Jehona Cami. Procesmbajtës: Fehmi Ajvazi.

RENDI I DITËS

- 1. Hyrje: z.Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së**
 - 2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të kuvendit komunal në Obiliq dhe Prishtinë;**
 - 3. Të ndryshme !**
-

1. Hyrje: z. Kreshnik Radoniqi, Kryesues i mbledhjes së KQZ-së:

Mbledhja nr. 39 e KQZ-së, është mbajtur në distancë përmes komunikimit teknikë.

2. Shqyrtimi dhe miratimi i kërkesës për zëvendësimin e anëtarit të Kuvendit Komunal në Obiliq:

Kjo mbledhje, është realizuar në distancë. Anëtarët e KQZ-së e kanë shqyrtuar dhe miratuar kërkesën e Kuvendit Komunal të komunës së Obiliqit lidhur me zëvendësimin e asamblistit nga kuvendi i kësaj komune. Në procedurë të rregullt dhe bazuar në aplikim, shqyrtim të kësaj kërkesë sipas kryesuesit të Këshillit për Çështje Ligjore z. Sami Hamiti, janë plotësuar kushtet që të bëhet ky zëvendësim. Rekomandohet KQZ që të procedoj më tutje.

Rekomandohet që znj. Lendita Krasniqi, të emërohet anëtare e Kuvendit Komunal në Obiliq nga subjekti politik “Lëvizja Vetëvendosje”, në zëvendësim të anëtares së deritashme të këtij kuvendi, znj. Ajshe Haliti Pllana.

Kanë votuar për lidhur me këtë rekomandim:

Sami Kurteshi, Sami Hamiti, Fazli Stollaj, Gordana Llaban, Myfera Shinik, Cemailj Kurtisi, dhe Kreshnik Radoniqi.